ZGJEDHJET E 11 MAJIT

QV TË NUMËRUARA 5216/5225 — SHQIPËRIA 1/2 — AZHORNIMI I FUNDIT 17:00

Partia	%	Mandate
Partia Socialiste e Shqipërisë	53.2 %	83
Partia Demokratike	33.0 %	50
Shqipëria Po Bëhet	4.0 %	1
Partia MUNDËSIA	3.1 %	2
	48.7 %	46.7 %	0.9 %	0.0

Kliko këtu për të gjitha rezultatet →

POP 5 Lajmet me të lexuara të 5 minutave të fundit

1. Veliaj sjell projektin e shesht ceremonial në fund të Bulevardit të Ri: Një tjetër hap drejt Tiranës moderne
2. Kërcënoi babain e kundërshtoi ato PS-në në Lezhë / Prokuroria vendosi ta lokojë në gjendje të lirë 27-vjeçari pasë e shkatërruar për mbrojtjen e vetës së Gjin Gjonit
3. 'Nga Cirk Tragjik': Figurat e 70-vë mogarësë janë dëshmitë të fushatës me LaCrivitas
4. VIDEO/ Fitkë për kryetarin shqiptar të MMA, largohet nga ringu me barasë dhe dërgohet në spital
5. Media amerikane 'Islands': Tjetër i gartë! Shqipëria!, i njohur për kënaqësitë, mysët me kaldërëm dhe kuzinën e shijshme

Kronikë

Tiranë/ 28-vjeçari vetëqëllohet me pistoletë në këmbë në lokal te 'Komuna e Parisit', Policia e prangos në spital! Arrestohen dhe dy shokët, i treti në kërkim! Fshehën ngjarjen (EMRAT)

I riu mbeti i plagosur në zonën e "Komunës së Parisit", në Tiranë. Ngjarja ndodhi brenda një lokali, në zonën e njohur si 'Iulishtja'. I plagosuri u dërgua në Spitalin e Traumës, jashtë rrezikut për jetën, me plagë në këmbë. Fiilimisht u dyshua për ngjarje kriminale, por pas hetimeve rezultoi vetëplagosje. I riu nën akuzë për armëmbajtje dhe fshehje të ngjarjes. Arrestohet kamerieri dhe një tjetër pasi e ndihmuan, i katërti në kërkim

Arma me të cilën u vetëqëllua i riu e sekuestruar nga policia

Sh.com Redaksia
18 Maj, 08:49 | Përditesimi: 18 Maj, 09:33

Share

Tiranë- Një person ka mbetur i plagosur si pasojë e të shtënave me armë zjarri në zonën e "Komunës së Parisit", në Tiranë (18 maj).

Ngjarja ka ndodhur pranë një kioske, në zonën e njohur si 'Iulishtja', rreth orës 01:20 të mëngjesit, në ambientet e një lokali.

I plagosuri është identifikuar si Kristjan Kaçorri, 28 vjeç. Ai ka marrë një plumb në këmbë dhe është transportuar menjëherë në Spitalin e Traumës, ku ndodhet jashtë rrezikut për jetën. Por pas zbardhjes së ngjarjes ai u prangos në gjendje spitalore për armëmbajtje pa leje dhe fshehje të ngjarjes. Në pranga janë edhe dy shokët e tij, **Airold Çami** dhe Arnold Malci, ky i fundit kamerier i lokalit. Në kërkim është një person i katërt, E.E., 41 vjeç, banues në Kuçovë.

LEXO EDHE:
Veliaj sjell projektin e sheshit ceremonial në fund të Bulevardit të Ri: Një tjetër hap drejt Tiranës moderne

Gazetari i Report Tv, Sokol Dema, informon se Policia ka nisur hetimet dhe ka zbardhur ngjarjen brenda disa orëve.

Nga hetimi i deritanishëm rezulton se në lokal kanë qenë tre shokë dhe kamerieri. Në këto momente, në rrethana ende të paqarta, Kristjan Kaçorri është vetëqëlluar me pistoletën që mbante pa leje në pjesën e këmbës. Teksa u dërgua te Trauma për mjekim, kamerieri sipas policisë ka fshirë vendngjarjen dhe të tjerat kanë fshehur gëzhojën e pistoletës nga jashtë lokalit.

> *"Nga hetimet e deritanishme dyshohet se 28-vjeçari është vetëplagosur aksidentalisht, në ambientet e një lokali në Komunën e Parisit, me një armë zjarri, të cilën e posedonte pa leje. Aktualisht, ky shtetas është në kujdesin e mjekëve dhe jashtë rrezikut për jetën. Ndërkohë, shtetasit A. C dhe E. E, kanë marrë armën e zjarrit dhe gëzhojën dhe i kanë fshehur në një ambient jashtë lokalit, ndërsa shtetasi A. M (kamarieri i lokalit) ka fshirë vendin e ngjarjes", njofton Policia e Tiranës.*

Aktualisht po zhvillohen veprime proceduriale me mbledhje provash, dëshmish dhe pamjesh filmike, për ta zbardhur plotësisht dinamikën e ngjarjes.

Njoftimi i Policisë së Tiranës:

"U vetëplagos me armën e zjarrit të cilën e posedonte pa leje, vihet në pranga 28-vjeçari.

Vihen pranga edhe dy shtetas të tjerë si dhe shpallet në kërkim një tjetër pasi ndihmuan në fshehjen e armës së zjarrit dhe vendit të ngjarjes. Sekuestrohet arma e zjarrit pistoletë.

Pas njoftimit të marrë se rreth orës 01:20, datë 18.05.2025, në spital kishte shkuar për mjekim, një shtetas i dëmtuar në këmbë, shërbimet e Komisariatit të Policisë Nr. 2 nisën hetimet me qëllim zbardhjen e rrethanave dhe dokumentimin e saj dhe si rezultat i veprimeve të shpejta hetimore dhe profesionale, në përfundim të tyre arrestuan shtetasit:

K. K., 28 vjeç, A. C., 33 vjeç dhe A. M., 30 vjeç, të tre banues në Tiranë. Si dhe shpallen në kërkim shtetasin E. E., 41 vjeç, banues në Kucovë.

Nga hetimet e deritanishme dyshohet se 28-vjeçari është vetëplagosur aksidentalisht, në ambientet e një lokali në Komunën e Parisit, me një armë zjarri, të cilën e posedonte pa leje. Aktualisht, ky shtetas është në kujdesin e mjekëve dhe jashtë rrezikut për jetën.

Ndërkohë, shtetasit A. C dhe E. E, kanë marrë armën e zjarrit dhe gëzhojën dhe i kanë fshehur në një ambient jashtë lokalit, ndërsa shtetasi A. M (kamarieri i lokalit) ka fshirë vendin e ngjarjes.

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë së Tiranës, për veprime të mëtejshme".

A.Q./Shqiptarja.com

TAG: kristjan kaçorri | komuna e parisit | spitali i traumes | plagosje me arme zjarri | Tirane | airold cami | arnold maci

Komento

Komente

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
Samiti evropian, besoni se do forcojë rolin ndërkombëtar të Shqipërisë?
16 Maj, 14:17

Po | Jo | Nuk e di

Lajme të tjera

Meta mesazh nga qelia pasi nuk fitoi, pranon rrudhjen e partisë: Nuk lejoj asnjë marifet djaliërizor për t'u bërë deputet nëpërmjet dorëheqjeve
18 Maj, 14:39

Tom Doshi mesazh votuesve: Pavarësisht luftës së ashpër nga forcat politike, ne ia dolëm! Besnikëria jonë e palëkundur, do punojmë për kontratën socialdemokrate me qytetarët
18 Maj, 13:41

'Lajm i mirë, motra e solli në Tiranë!' Marrëveshja me Italinë për pensionet, Meloni i dërgon Ramës dokumentin ligjor: Nga 1 qershori shqiptarët e Italisë do nisin të përfitojnë
18 Maj, 12:41

Sulm ndaj medias gjatë protestës së PD-së, Policia çon në SPAK Edi Palokën dhe Klevis Balliun! U sulmuan edhe gazetaret e Report Tv
18 Maj, 11:55

Rrahu për vdekje në Greqi bashkëatdhetarin më 2010, Prokuroria e Tiranës çon në gjyq të arrestuarin Dritan Hoxha! Historia e një krimi dhe zbardhja
18 Maj, 10:49

Bëri fushatë për kushëririn që kandidoi për Berishën, Policia zbardh detajet: Në ambientet e ish-kryebashkiakut Elvis Roshi u sekuestruan telefoni, fatura, kupona nafte e lista zgjedhësish! (EMRAT)
18 Maj, 09:47

Samiti i VI-të i Komunitetit Politik, Rama ndan 'buqetën' me shkrepjet më pikante nga eventi: Foto-albumi i mikpritjes shqiptare për Europën!
18 Maj, 09:05

FOTO-LAJM/ Tirana në dy kohë, pas vjedhjes së zgjedhjeve nga Berisha më 26 maj 1996 dhe pas 11 majit 2025! Rama ndan fotot e retrospektivës politike e historike të Shqipërisë
18 Maj, 08:35

VIDEOLAJM/ Takimi i veçantë, Renzi i shtrëngon faqet Ramës! Nuk mungon as përgafimi dhe biseda miqësore
17 Maj, 21:45

Tiranë/ Aksident në bulevardin 'Zhan D'ark', dy të plagosur
17 Maj, 20:13

Pas BE, vjen edhe mesazhi nga SHBA! Dhëndri i Trump: Rama, politikan i zotë! E ka bërë Shqipërinë një vend të sigurt për të investuar! Resorti në Sazan, diçka spektakolare
17 Maj, 16:33

'Vendi juaj është në BE!' Macron ndaj VIDEO-mesazhin në shqip për vizitën në Tiranë: Falemiderit për mikpritjen, miqësia jonë e fortë, ne po e çojmë në majat më të larta
17 Maj, 16:10

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

HOROSKOPI

© 2011 - 2025 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i pasaktësuar i kesaj faqeje